



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 268142; Fax 04 268141

Nr. 2945 Prot

Tiranë, më 01.07. 2015

V E N D I M

Nr. 62, datë 01 / 07 2015

Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Tiranë

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; neneve 14 germa "b", 32 e 33 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit" miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (më poshtë rregullores), si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me inspektimin e zhvilluar në Këshillin e Qarkut Tiranë,

VËREJ SE:

Këshilli i Qarkut Tiranë, me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 "*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*" ka kryer procesin e ristrukturimit të institucionit. Si rrjedhojë e pakësimit të ndjeshëm të fondeve financiare në buxhet, procesi i ristrukturimit është shoqëruar me reduktimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Qarkut Tiranë, duke vendosur lirimin e disa prej tyre nga shërbimi civil.

Duke e konsideruar të padrejtë aktin administrativ të lirimit nga shërbimi civil, me pretendimin se ka dalë në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 50 e vijues të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, një prej ish-punonjësve të Këshillit të Qarkut Tiranë ka kërkuar verifikimin e rregullshmërisë së procesit të ristrukturimit nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në këto rrethana, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, duke vlerësuar nevojën për verifikim të këtij informacioni, me aktin administrativ nr. 31, datë 31.03.2015, "*Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Tiranë*", vendosa kryerjen e inspektimit të

përgjithshëm, duke përfshirë në objektin e inspektimit, procesin e ristrukturimit, si dhe duke e zgjeruar më tej inspektimin, në të gjitha institutet e tjera të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.

Inspektimi u zhvillua në përputhje me vendimin nr. 31, datë 31.03.2015, të përmendur më sipër, i cili në bazë të nenit 21 të rregullores, i është njoftuar institucionit me shkresën nr. 290 prot., datë 31.03.2015, "*Njoftim mbi fillimin e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Tiranë*". Në përfundim të procesit të inspektimit të përgjithshëm, në përmbajtje të të cilit u trajtuan gjithë aspektet e administrimit të shërbimit civil, sipas parashikimit në planin e inspektimit, grupi i mbikëqyrjes hartoi projektraportin, i cili i është dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 290/3 prot., datë 26.05.2015, "*Dërgohet projekt raporti i inspektimit në institucionin e Këshillit të Qarkut Tiranë, në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil*", duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin. Pas kësaj, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe përgjegjësjë e sektorit juridik dhe administratës, me shkresën nr. 1135/1 prot., datë 02.06.2015, "*Mbi projektraportin e inspektimit të grupit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil*", regjistruar pranë Komisionerit me nr. 290/4 prot., datë 04.06.2015.

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse, rezulton se subjekti i inspektuar është shprehur dakord me rekomandimet e nxjerra nga grupi i punës dhe nuk ka bërë asnjë vërejtje në lidhje me materialin.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar. Në këto rrethana, pasi shqyrtova përmbajtjen e raportit përfundimtar të inspektimit, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, në përfundim, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe Rregulloren "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Këshilli i Qarkut Tiranë, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, duhet të rishikojë emërtesat e pozicioneve dhe të bëjë unifikimin e tyre sipas kërkesave të ligjit nr. 90/2012, "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*" (Titullari i institucionit të nxjerrë një akt administrativ për rregullimin dhe unifikimin e tyre).

3. Njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 115 të Kodit të procedurave Administrative, duhet të bëjë revokimin e akteve të konfirmimit si nëpunës civil, përkatësisht për ***** dhe ***** dhe, në zbatim të nenit 24, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, të Këshillit të Ministrave, t’i dërgojë ata për të bërë trajnimin e detyrueshëm të ASPA-s si dhe të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë.
4. Format i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil të jetë sipas lidhjes 4, bashkëlidhur Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të Këshillit të Ministrave dhe të nënshkruhen nga nëpunësi civil, eprori direkt i nëpunësit civil, si dhe nga Sekretari i Përgjithshëm.
5. Të kryhen vlerësimet vjetore të punës për çdo punonjës në zbatim të nenit 62, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”*.
6. Të revokohet akti i deklarimit të statusit të punësimit për ***** dhe të përsëritet procedura e deklarimit të statusit të punësimit, duke iu njohur statusi si nëpunës civil. Pas kësaj të bëhet vlerësimi, nëse plotësohen ose jo prej saj, kërkesat e pozicionit të punës, të mbetur ose krijuar pas ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Tiranë.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
8. Për këtë vendim të njoftohet Këshilli i Qarkut Tiranë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të inspektimit dhe, njëkohësisht, të informohet Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA